

**Regional Development Agency (SME)
Tirana**

Rruga Ismail Qemali, P 34/1, Ap 2/3
Tel: 254603. Fax: 235704



MARKET STUDY FOR PLASTIC PACKAGING INDUSTRY (BAGS, SACKS AND WRAPS) IN ALBANIA

**Study realized
By:**

**REGIONAL DEVELOPMENT AGENCY
(SME) TIRANE**

**This market study is requested and financed by both IFC–Recycling
Linkages and Everest IE Ltd**

Tirane, June 2007

STRUKTURA E STUDIMIT

I. HYRJE

- I.1 Historiku i industrise plastike ne vendin tone
- I.2 Nje veshtrim i pergjithshem i prodhimit dhe riciklimit te amballazheve plastike ne bote
- I.3 Veshtoresite dhe prioritete e kesaj dege te industrise.

II. TREGU I AMBALLAZHEVE PLASTIKE PREJ POLIETILENI (FLETE E QESE POLIETILENI) NE SHQIPERI

- II.1 Fushat e perdorimit te amballazheve plastike prej polietileni (flete dhe qese polietileni).
- II.2 Analiza e importit te lendeve te para te prodhimit te qeseve prej polietileni.
- II.3 Analiza e importit te amballazheve prej polietileni (qese dhe thase te ndryshem).
- II.4. Firmat vendase kryesore importuese.
- II.5. Firmat kryesore vendase te prodhimit te fleteve te polietilenit, dhe amballazheve te ndryshme prej polietileni si qese, canta e thase te ndryshem.

III. TEKNOLOGJIA E PRODHIMIT DHE TE AMBALLAZHEVE PLASTIKE PREJ POLIETILENI (FLETE E QESE POLIETILENI).

III. KONKURENCA NE TREG

IV. VROJTIME DHE SUGJERIME

I. HYRJE

I.1. Historiku i industrise plastike ne vendin tone

Deget e industrise se lehte qe merren me prodhimin e perpunimin e lendeve plastike jane ngritur pas clirimit te vendit. Artikujt e pare plastike si amballazhe per kozmetike, kopsa e materiale elektroteknike, filluan te prodhohen per here te pare me 1955 ne Tirane me rreshira te tipit termoreaktive (galit, bakelit dhe aminoplast). Me 1961 u ngrit nje repart i vogel prane fabrikes se gomes ne Durres dhe filloi perpunimi i rreshirave termoplastike (klorur polivinili, polistiren) per prodhimin e artikujve per perperdorim te gjere me makineri te thjeshta te prodhuara ne vend.

Ne Uzinen e Telave te Shkodres, filloi me 1965 prodhimi i telave dhe kablllove elektrike me veshje prej lendesh plastike, si klorur polivinili dhe polietileni ose nga kombinimi i tyre. Ne vitin 1968-1969 u be zgjerimi i repartit te lendeve plastike prane Fabrikes se Gomes ne Durres dhe filloi prodhimi i sandaleve dhe kepuceve prej lendesh plastike, i tubave prej klorur vinili per istalimet elektrike, i fleteve prej polietileni me gjeresi deri ne 4 metra per mbulimin e serave, i disa lloj enesh etj. Me 1970 u vu ne shfrytezim Fabrika e re e Lendeve Plastike ne Durres dhe me 1976 Uzina e Lendeve Plastike ne Lushnje e cila perpunon klorurin e polivinilit te prodhuar ne vend nga Uzina e Sodes dhe te rreshirave polivinilike ne Vlore. Ne Uzinen e Lendeve plastike ne Lushnje prodhoheshin thase amballazhi plastike, flete polietileni me gjeresi deri ne 4 metra per mbulimin e serave me ngrohje diellore, tuba te forte deri 250 mm qe durojne trysni deri ne 6 atmosfere e qe perdoren kryesisht per ujitje ne bujqesi, pllaka te buta e te forta, artikuj per perdorim te gjere (linoleum, mushama shiu, mbulesa tryeze, tekstile te veshura me PVC). U prodhuan gjithashtu kokrriza PVC te forta e te buta, per nevoja te ndermarrjeve te tjera. Me pas u prodhuan edhe tuba te forte per ujitje e drenazhim te tokave, amballazhe te ndryshme, pjese nderrimi plastike, artikuj te ndryshem plastike te perdorimit te gjere, tekstile te plazmuara, lodra per femije etj. Me 1982 prodhimi i pergjitheshem i lendeve plastike u rrit gadi 15 here ne krahasim me vitin 1970.

Vitet 90-te sollen ndryshime te thella ne te gjithe dimensionet e shoqerise shqiptare. Ne kushtet e kalimit, nga nje sistem me ekonomi te centarlizuar ne nje sistem ekonomik bazuar ne parimet e tregut te lire, lindi nevoja edhe e shnderrimit te pronesise nga shteterore ne private.

Privatizimi ne vetvete ndikoi ne ekonomine e vendit ne menyra te ndryshme. Keshtu industria jo vetem qe nuk u stabilizua por u ngadalesua dhe ne shume raste u mbyll perfundimisht per shkak te veshtiresive te medha qe hasnin fabrikat dhe uzinat ne perballimin e konkuresces me mallrat e importit, si rezultat i teknologjive te tyre te vjeteruara. Ndermjet faktoreve te tjere, kostot e larta te lendeve te para te importuara, joefikasiteti ne drejtimin e ndermarrjeve shteterore dhe rregullat e reja te tregut, bene qe produktet e prodhuara ne vend te jene me